



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272308

Datë: 06.02.2024

Numri i dokumentit: 05290146

C – IV. - 15 - 0742

Paditësi:

H J, nga fshati L i Komunës së Prizrenit.

Kundër

E paditura:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Lagjja, "Lakrishtë", Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Prishtinë.

Për : Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.06.02.2024**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit, H J, nga fshati L i Komunës së Prizrenit e paraqitur kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe Vendimi, PRZ009-0231 i dt.23.03.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, **VËRTETOHET si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me dt.23.04.2015, paditësi H J, nga Prizreni, përmes dërgimit me postë, në DhPGJSK, ka parashtruar, kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit, PRZ009-0231 të dt.23.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) lidhur me NSh, "D.L.B. Lavërtari-Blegtori" (në likuidim) me seli në Prizren, e me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënie së punës për 7 paga x 187.01, në shumë të përgjithshme prej 1.309.07 euro, për shkak vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të shfuqizohet vendimi i kundërshtuar, dhe të vendoset në bazë të Ligjit për AKP-në.

Pala paditëse parashtresën e ka titulluar si "*kërkesë për rishqyrtim*", mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomen e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet "*nisja e procedurave*" pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi në padinë e tij thekson se, ka qen punëtor në marrëdhënie të rregullt pune, dhe se NSh “D.L.B. Lavërtari-Blegtori” (në likuidim) me seli në Prizren, dhe me kohë e ka paraqitur kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës për 7 muaj x 187.01 euro, që në shumë totale përbën 1.309.07 euro, e cila kërkesë është refuzuar nga AL-ja me Vendimin e AL-së, PRZ009-0231 të dt.23.03.2015, me zbatim të gabuar të së drejtës së Ligjit për AKP-në, duke arsyetuar se kërkesa me kohë është dorëzuar brenga afatit, por duke iu referuar nenit 36.2.1, dhe nenit 36.2.2, ndërsa më tej citon se i është referuar nenit 40.1.6.1 të Aneksit të Ligjit për AKP-në, duke shtuar se AL-ja, veprimi në kundërshtim edhe me nenin 39 të aneksit të Ligjit për AKP, për hartimin e listës përfundimtare të kërkesave, duke cituar listat aktive dhe pasive, dhe të gjithë punëtorët duhet të trajtohen të barabartë, e jo si të diskriminuar dhe me shkelje të ligjit me mos zbatim të dispozitave nga neni 40 i aneksit në procedurë të likuidimit, duke theksuar më tej, se në shpjegim i referohet edhe Ligjit të Punës së Bashkuar, se AL e ka konsideruar kërkesën të paraqitur brenda afatit dhe duke e refuzuar si të pavlefshme dhe atë në kundërshtim me protokollin 1 të Konventës për të Drejtat e Njeriut.

Padisë/ankesës së tij si prova, paditësi, ia ka bashkëgjetur vetëm, Vendimin e AL-së, PRZ009-0231 dt.23.03.2015, e asnjë provë tjetër.

Me dt.21.11.2023, e paditura, AKP me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë ka parashtruar mbrojtjen e saj në ankesën e paraqitur nga pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit, ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, se ankesa e parashtruesit është e pa pranueshme pasi që objekt i kësaj procedure gjyqësore, është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria e me Ligjin, Nr.04/L-034) e Vendimit të AL-së, dhe se në këtë kontekst, neni 74.2 i Ligjit, nr.06/L-086, parashikon se ankesa e dorëzuar në DhPGJS kundër Vendimit të AL-së, duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit, nuk është kryer në përputhje me Ligjin, nr.04/L – 034 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, se parashtruesi nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore që e ka shkelur Autoriteti i Likuidimit (AL), andaj vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit nr.04/L - 034, dhe se nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin, dhe se ankesa është e pavlefshme. E paditura, më tej në këtë mbrojtje, ka cituar se pretendimet e parashtruesit janë të parashkruara, pasi nuk asnjë provë përpara AL që parashtruesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent, ankesa është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në dhe nenit 60 të Ligjit të Punës së Bashkuar, se AL-ja ka kryer vlerësimin e kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku parashikon se : “ ... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme. Në bazë të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë organ tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe t’ua vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit, Nr.06/L – 086 dhe se mbrojtjes si provë i ka bashkëgjetur: Vendimin e AL-së, PRZ009-0231 të dt.23.03.2015.

Me Urdhrin e saj, C – IV. – 15– 0742 të dt. 21.11.2023, kjo gjykatë, mbrojtjen e të paditurës, ia ka adresuar paditësit, për të dhënë përgjigje në këtë mbrojtje, dhe atë brenda afatit prej 7 ditëve, dhe në përgjigjen e dhënë duhet t’ia bashkëngjiste provat që i kishte paditësi, në mbështetje të padisë së tij dhe të pranuar nga paditësi dt.23.11.2023 por i njëjti nuk i është përgjigjur urdhrin të kësaj gjykate.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit, duhet të refuzohet e pabazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, dhe ka konstatuar se NSH “D.L.B. Lavërtari-Blegtori” (në likuidim) me seli në Prizren, me dt. 07.07.2014, ka hyrë në procedurën e likuidimit, ndërsa parashtruesi – tani paditësi me dt.19.08.2013, ka parashtruar kërkesën me pretendimin për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontrates së punës të për 7 paga x 187.01, në shumë të përgjithshme prej 1.309.07 euro, e cila kërkesë është refuzuar me Vendimin e AL-së, PRZ009-0231 së dt.23.03.2015 lidhur me NSH, “D.L.B. Lavërtari-Blegtori” me seli në Prizren, (në likuidim) duke e konsideruar si të pavlefshme, e kundër të cilit vendim të pranuar, pas dt.23.03.2015, në DhPGJSK, paditësi, me dt.23.04.2015, ka paraqitur kërkesë për ri shqyrtimin e Vendimit në fjalë, dhe se njëjta kërkesë, është bërë brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditë së pranimit të Vendimit të kontestuar të AL-së, PRZ009-0231 të dt.23.03.2015 dhe se të njëjtës kërkesë/padi, ia ka bashkangjitur të njëjtin Vendim të AL-së. Andaj gjykata, vlerëson se padia e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë në aspektin procedural sipas dispozitave ligjore nga neni 36 dhe 74 Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese se në mes të palëve ndërgjyqëse, ka qëndruar raporti juridik i marrëdhënies së punës në mes të ankuesit dhe NSH “D.L.B. Lavërtari-Blegtori” (në likuidim) me seli në Prizren, e të cilën tani e përfaqëson AKP-ja, për të cilën i njëjti fakt nuk kontestohet nga palët ndërgjyqëse, por kontestuese mes palëve, është se pala paditëse me rastin e parashtrimit të kërkesës para AL në procedurë të likuidimit, përkatësisht me rastin e shqyrtimit të kërkesës së paditësit nga AL, bazuar në arkivin e NSH si dhe në listën e pagave dhe punëtorëve aktiv për periudhën nga muaji gusht 2012 deri në gusht 2013, parashtruesi përgjatë tërë kësaj periudhe nuk ka ofruar shërbime për NSH dhe si rrjedh ka rezultuar se nuk ishte punëtorë aktiv në këtë NSH, për të cilën ka rezultuar se parashtruesi tani paditësi nuk ka ofruar shërbime për ndërmarrjen para se të privatizohet apo të hynte në likuidim, dhe si rrjedhojë nuk është pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga agjencia siç parashikohet në nenet 6.1 dhe 6.2

të Ligjit për AKP, mbi bazën e të cilët AL-ja, ka konstatuar se parashtruesit nuk i takon e drejta për përfitim nga dëmshpërblimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës siç pretendon parashtruesi.

Gjykata gjen se parashtruesi edhe me rastin e parashtrimit të padisë kundër vendimit të kundërshtuar nuk ka paraqitur ndonjë fakt apo provë me të cilën gjykata mund të vendoste ndryshe nga AL me rastin e refuzimit të kërkesës. Andaj AL me rastin e shqyrtimit të kërkesës së paditësit ka vërejtur në arkivin e NSh-së si dhe në listën e pagave dhe punëtorëve aktiv për periudhën nga muaji gusht 2012 deri në gusht 2013, parashtruesi përgjatë tërë kësaj periudhe nuk ka ofruar shërbime për NSh-në dhe si rrjedh ka rezultuar se nuk ishte punëtorë aktiv në këtë NSh, dhe se në veprimet e AL nuk ka veprime ndaj parashtruesit me të cilën mund të realizonte të drejta në pretendimet e tij, dhe si rrjedhojë nuk është pushuar nga puna si pasoj e një veprimi të ndërmarrë nga agjencia siç parashikohet në nenet 6.1 dhe 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Gjykata gjen se pretendimet e paraqitura nga paditësi nuk konsistojnë me asnjë provë me të cilën gjykata mund të vepronte në miratimin e kërkesës, pasi që një kërkesë e tillë duhet të paraqitet me fakte dhe prova, e me të cilën gjykata mund të vendoste me fakte vendimtare se pretendimet e paditësit janë të bazuara në prova. Paditësi që me rastin e parashtrimit të padisë ka pasur mundësi që të paraqesë çdo provë të mundshme në arsyetimit e kërkesës, por me rastin e parashtrimit të padisë ka bashkangjitur vetëm vendimin e kundërshtuar, ndërsa me rastin e pranimit të mbrojtje së të paditurit të paraqitur në kundërshtimin e kërkesës së paditësit gjegjësisht me Urdhrin e kësaj gjykate, C – IV. – 15 – 0742 e dt.21.11.2023, të pranuar nga paditësi dt.23.11.2023, kjo gjykatë i ka dhënë mundësinë paditësit që me rastin për të dhënë përgjigje në mbrojtje, duhet t’ia bashkëngjiste provat që poseduar në mbështetje të padisë, por nuk i është përgjigjur gjykatës, andaj me të drejtë AL ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit tani paditësit.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë, aty thuhet se : *“Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2.”* .

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës e paraparë në nenin 40 par.1 pika 6.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, dhe i cili që flet për prioritetet e kërkesave dhe interesave, ku aty thuhet se : *Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... 1.6. kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim: ... kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në”* .

Po ashtu në nenin 42 par.3 i Ligjit nr. 06/L – 086, në mënyrë shprehimore, thuhet se “... Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë” .Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile, padinë/ankesën e paditësi të ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRZ009-0231 të dt.23.03.2015 për NSh, “D.L.B. Lavërtari-Blegtori” me seli në Prizren (në likuidim) për kompensimin në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, duhet t’a refuzojë si të pabazuar.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës

Gjykata vlerëson se, qëndrimi i të paditurës i shprehur në Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL), PRZ009-0231 të dt.23.03.2015, ku e ka bërë refuzimin e kërkesës së parashtruesit për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, është i drejtë, duke vlerësuar si të pavlefshme të kërkesën e parashtruesit, pasi që AL-ja me rastin e likuidimit të ndërmarrjes, nuk ka marrë asnjë veprim me të cilën do t'ia kufizonte të drejtën e paditësit në realizimin e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës, pasi që ka rezultuar se nuk ishte punëtor aktiv në këtë NSh, me rastin e likuidimit në NSh, andaj edhe gjykata me rastin e shqyrtimit të padisë në këtë procedurë gjyqësore bazohet në obligimet e palëve në procedurë se në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi, dhe se ajo palë që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), për të cilën pala paditëse nuk ka paraqitur para kësaj gjykate vendimmarëse, andaj me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditësit, H J, nga fshati L i Komunës së Prizrenit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënie së punës 7 paga x 187.01, në shumë të përgjithshme prej 1.309.07 euro e paraqitur kundër të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, e refuzoj si të pa bazuar derisa Vendimin, PRZ009-0231 të dt.23.03.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për NSh, “D.L.B. Lavërtari-Blegtori” me seli në Prizren (në likuidim), e vërtetoj si të drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) dhe Udhëzimit Administrativ, Nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore përkatësisht nenit 13.3 dhe 13.9, të këtij Udhëzimi, gjykata vendosi që secila palë t'ia bartë shpenzimet e veta procedurale.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS
2022:272308, 06.02.2024

Gjykatësi
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi nga pala e pa kënaqur mund të parashtrohet ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe atë brenda afatit prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve**, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPSGjSK)